



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/38

Datë: 02.10.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, nenit 9.1 të Ligjit nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 tetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Kurdo që është e përshtatshme pas themelimit, në pajtim me vendimin e Qeverisë për Kompaninë për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, si kompani me investime të përbashkëta ("JSC"), kompania e tillë do të privatizohet përmes tenderit publik dhe shitja e aksioneve të saj do të bëhet në pajtim me kërkesat e nenit 9 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin për fillimin e procedurave të privatizimit të distribuimit dhe furnizimit të KEK-ut, t'ia procedojë për aprovim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë